



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 300 Prot.

Tiranë, më datë 12.07.2019

VENDIM

Nr.249, datë 12.07.2019

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT ZHVILLIMOR

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48, pika 1 dhe neni 134, pika 1, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 12.07.2019, pas shqyrtimit të projektit në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Ndërtimi hidrocentrali Vokopola 1, Vokopola 2 dhe Vokopola 3”, në lumin Vokopolë, Bashkia Skrapar, me subjekt aplikues “VOKOPOLA ENERGJI” sh.p.k.;  
- *Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objekteve monument kulture:*  
“Ura e Vokopolës afër Ujit të Zi”, fshati Vokopolë dhe “Rrënojat e Urës së Palecit”, fshati Tozhar, Bashkia Poliçan;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

Arta Dollani

KRYETAR

Elva MARGARITI

